

VENDIM
Nr. 613, datë 2.10.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 111, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Krijimin dhe administrimin e fondit social nga njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, për të siguruar zhvillimin e politikave sociale, përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese, si dhe planifikimin e krijimit të shërbimeve të reja.”.

2. Pika 4.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4.1 Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe harton planin social vendor, duke identifikuar ato shërbime që mbeten të pafinancuara, bazuar në programin buxhetor afatmesëm.”.

II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministri përgjegjës për pushtetin vendor dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku